

VENDIM
Nr. 123, datë 1.3.2023

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 141, DATË 22.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 7, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 141, datë 22.2.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “...institucion qendror buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike...” zëvendësohen me “...institucion juridik publik buxhetor me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit...”.

2. Në pikën 2, togfjalëshi “me seli në Tiranë” hiqet.

3. Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me këtë përmbajtje:

“6/1. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të Autoritetit rregullohen në bazë të Kodit të Punës.”;

“6/2. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm. Në detyrën e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm caktohet një nga drejtorët e përmbajtjes së Autoritetit, i cili krahas detyrave funksionale, kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga drejtori i përgjithshëm për të mbështetur atë në mbarëvajtjen e institucionit.”.

4. Pika 7.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7.3 Raporton në mënyrë periodike për veprimtarinë e institucionit pranë Kryeministrit.”.

5. Në pikën 7.4, fjalët “... ministrit përgjegjës të fushës...” zëvendësohen me emërtimin “...Kryeministrit...”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku